**V E N D I M**
**Nr.46, datë 29.1.1993**

**PËR TRAJTIMIN E BANESAVE NË PROCES NGA VITI 1992**

Në mbështetje të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe të Rregullimit të Territorit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Banesat në proces nga viti 1992 të ndahen në:

a) Banesa që ndërtohen nga ndërmarrjet ekonomike (ish me ndihmesë vullnetarë).

b) Banesa që ndërtohen me investime (me ndërmarrjet e sistemit të Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe të Rregullimit të Territorit).

2. Banesat në proces që ndërtohen nga ndërmarrjet ekonomike (ish me ndihmesë vullnetarë) do të trajtohen si më poshtë:

a) Banesat, të cilat komisioni i marrjes në dorëzim i ka kontrolluar dhe ka lidhur aktmarrëveshjen duke lënë detyra, do të financohen nga buxheti i shtetit për vitin 1993, nëpërmjet të njëjtit investitor.

Kjo kategori banesash do të trajtohet sipas ligjit të privatizimit të banesave shtetërore, duke zbatuar një tarifë shtesë prej 20 për qind mbi tarifën bazë.

b) Për banesat në proces, që janë në fazën e punimeve të karabinasë nga kati i dytë deri në katin e fundit ose të papërfunduara, do të veprohet në këtë mënyrë:

- Ju falet ndërmarrjeve ekonomike përkatëse vlera e punimeve të kryera në fakt. Këto ndërmarrje t'i përfundojnë këto banesa me mundësitë e tyre financiare dhe t'ua ndajnë punonjësve të tyre sipas dispozitave në fuqi.

- në qoftë se ndërmarrja ekonomike nuk e përfundon dot banesën me mundësitë e saj financiare, atëherë ajo bën ndarjen e banesës për punonjësit e saj, të cilëve u falet vlera e punimeve faktike. Këta punonjës janë të detyruar ta përfundojnë banesën me mundësitë e tyre financiare, duke zbatuar projektin dhe kushtet teknike të zbatimit.

Nëse katër muaj pas daljes së këtij vendimi nuk është gjetur zgjidhja e ndërtimit të banesës sipas dy paragrafëve të mësipërm, atëherë këto banesa u lihen në dispozicion bashkive dhe komunave me gjithë vlerën e punimeve të kryera.

Trajtimi i kësaj kategorie banesash (pika "b") u ngarkohet bashkive dhe komunave.

3. Banesat që ndërtohen nga ndërmarrjet ekonomike (ish me ndihmese vullnetare) që janë në fazën e punimeve të themeleve deri në katin e parë, pa filluar kati i dytë, vihen në dispozicion të Entit Kombëtar të Banesave dhe ndërmarrjet ekonomike humbin çdo të drejtë mbi to.

4. Për banesat në proces që ndërtohen me investim (me ndërmarrjet e sistemit të Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe të Rregullimit të Territorit), do të veprohet si më poshtë:

a) Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit të marrë të gjitha masat për vazhdimin e punimeve.

b) Banesat, të cilat komisioni i marrjes në dorëzim i ka kontrolluar dhe ka lidhur aktmarrëveshjen duke lënë detyra, do të financohen nga Enti Kombëtar i Banesave. Këto banesa do të trajtohen sipas ligjit për privatizimin e banesave shtetërore, duke zbatuar një tarifë shtesë prej 20 për qind mbi tarifën bazë. Punimet e rrjetit inxhinierik për këto banesa do të përballohen nga buxheti i shtetit.

c) Për banesat në proces që janë në fazën e karabinasë nga kati i dytë deri në katin e fundit ose të papërfunduara, përveç atyre të përfshira në pikën "b", shpenzimet e bëra nga Enti Kombëtar i Banesave për përfundimin e plotë të tyre. Rrjeti inxhinierik i tyre do të financohet nga buxheti i shtetit.

5. Për të gjitha banesat e tjera që janë në proces, me përjashtim të banesave të përmendura në pikat 2/a, 2/b dhe 4/b, autorizimet e lëshuara deri tashti do të quhen të pavlefshme dhe shpërndarja e tyre do të bëhet nga rrethet, bashkitë e komunat sipas kritereve të caktuara nga Këshilli i Ministrave.

6. Për të gjitha rastet e mësipërme do të respektohen aktmarrëveshjet e bëra nga qytetarët me organet përkatëse të pushtetit lokal, të cilëve u është prishur banesa për efekt të planit rregullues. Këta qytetarë fitojnë banesën sipas ligjit të privatizimit të banesave shtetërore.

7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, rrethet, bashkitë e komunat.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
**Aleksandër Meksi**